



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 391/2022
Datë: 07.10.2022

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1 dhe 2.9), të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Dafina Gexha - Bunjaku, emërohet ushtruese e detyrës së Ministres së Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministres së Ministrisë së Shëndetësisë janë të përcaktuara me Rregulloren (QRK) - Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, me legjislacionin në fuqi, si dhe kryen detyra tjera shtesë të caktuara nga Kryeministri.
3. Ministrja është e obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Znj. Dafina Gexha - Bunjaku, u.d. Ministre e Ministrisë së Shëndetësisë;
- Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të Stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.